



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 199, Datë 24.11.2017

MBI

MIRATIMIN E KONTRATËS SË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR NDËRMJET SHOQËRISË ALBGAZ SH.A DHE ALBPETROL SH.A.

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” si dhe nenit 16 dhe 17 gërma “ç”; 35; 36 dhe 80 pika 8 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin Gazit Natyror”; pika 8 e VKM nr. 848, datë 07.12.2016, për “Krijimin e Shoqërisë Albgaz sh.a dhe për Caktimin e Autoritetit Publik që përfaqëson Shtetin si Pronar të Aksioneve të shoqërisë Albpetrol sh.a dhe Albgaz sh.a”; nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 24.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për miratimin e kontratës së shërbimit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së gazit natyror ndërmjet shoqërisë Albgaz sh.a dhe Albpetrol sh.a, me nr. 55/1 Prot. i Albgaz, datë 05.07.2017 dhe nr. 4608 Prot. i Albpetrol, datë 06.07.2017,

Konstatoi se:

- Shoqëria "Albgaz sh.a", ushtron aktivitetin si Operator i Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Natyror në Shqipëri, në zbatim të VKM nr. 848, datë 07.12.2016 për "Krijimin e Shoqërisë Albgaz sh.a dhe për Caktimin e Autoritetit Publik që përfaqëson Shtetin si Pronar të Aksioneve të shoqërisë Albpetrol sh.a dhe Albgaz sh.a".
- Albgaz sh.a. me shkresën nr. 81 Prot., datë 24.08.2017, protokolluar me tonën nr. 167/16 Prot, datë 25.08.2017, ka depozituar në ERE kërkesën për miratimin e Kontratës së Shërbimit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Natyror, të dakortësuar ndërmjet përfaqësuesve të shoqërisë: “Albgaz” sh.a. dhe shoqërisë “Albpetrol” sh.a.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 176, datë 26.10.2017, ka filluar procedurën për miratimin e kontratës së shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror ndërmjet shoqërisë Albgaz sh.a dhe Albpetrol sh.a, me nr. 55/1 Prot. i Albgaz, datë 05.07.2017 dhe nr. 4608 Prot. i Albpetrol, datë 06.07.2017.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 179, datë 08.11.2017 ka Certifikuar shoqërinë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror, Albgaz” sh.a. dhe me vendimin, Nr. 90, datë 07.06.2017, ka

miratuar tarifën e përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a. për periudhën 05.01.2017 – 20.09.2017”, ndryshuar me vendimin nr. 155, datë 28.09.2017.

- Bordi i ERE me vendimin nr. 178, datë 08.11.2017, ka miratuar Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 187 datë 10.11.2017, ka licencuar shoqërinë Albgaz sh.a. në aktivitetin e Shpërndarjes së gazit natyror.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 188 datë 10.11.2017, ka licencuar shoqërinë Albgaz sh.a. në aktivitetin e Transmetimit të gazit natyror.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

Vendosi:

1. Të miratojë kontratën e shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror ndërmjet shoqërisë Albgaz sh.a dhe Albpetrol sh.a. me nr. 55/1 Prot. i Albgaz, datë 05.07.2017 dhe nr. 4608 Prot. i Albpetrol, datë 06.07.2017. (bashkëlidhur)
2. Drejtoria e e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kërkesa për rishikimin e këtij vendimi, mund të bëhet në ERE brenda 7 ditëve kalendarike.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI